

POLITIKA E PRIVATËSISË DHE COOKIES

VËSHTRIM MBI POLITIKËN TONË TË PRIVATËSISË DHE COOKIES

- KUSH JEMI NE.** Ne jemi **ITX ALBANIA SHPK** dhe **Industria de Diseño Textil, S.A.** (Inditex, S.A.), S.A., dhe i përpunojmë të dhënat tuaja personale si *bashkë-kontrollues*. Kjo do të thotë që ne jemi bashkërisht përgjegjës për mënyrën se si përpunojmë dhe mbrojmë të dhënat tuaja. [Shiko më shumë.](#)
- PËR ÇFARË I PËRDORIM TË DHËNAT TUAJA.** Ne do të përdorim të dhënat tuaja (të mbledhura në internet ose personalisht), ndër qëllime të tjera, **për të menaxhuar regjistrimin tuaj** si përdorues, **për të menaxhuar blerjet tuaja** të produkteve ose shërbimeve, për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja, dhe, nëse dëshironi, për t'ju dërguar komunikime të personalizuar. [Shiko më shumë.](#)
- PËRSE I PËRDORIM TË DHËNAT TUAJA.** Ne kemi status ligjor për të përpunuar të dhënat tuaja për arsye të ndryshme. Arsyeja kryesore është që ne duhet t'i përpunojmë të dhënat tuaja **për të zbatuar kontratën** që ju pranoni me ne kur regjistroheni dhe kur bëni blerje ose gëzoni ndonjë nga shërbimet ose funksionalitetet tona. Ne gjithashtu përdorim të dhënat tuaja për arsye të tjera, për shembull, për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja ose për t'ju dërguar buletinet që keni kërkuar të merrni nga ne. [Shiko më shumë.](#)
- ME KË I NDAJMË TË DHËNAT TUAJA.** Ne i ndajmë të dhënat tuaja me ofruesit e shërbimeve që na ofrojnë ndihmë ose mbështetje, të cilat janë kompani në Inditex Group ose ofrues të palëve të treta. [Shiko më shumë.](#)
- TË DREJTAT TUAJA.** Ju keni të drejtë të përdorni, ndryshoni ose fshini të dhënat tuaja personale. Në raste të caktuara, ju keni të drejtë edhe për të drejta të tjera, të tilla si, për shembull, të kundërshtoni përdorimin nga ana jonë të të dhënave tuaja, ose për transferimin e të dhënave tuaja, siç shpjegohet në detaje më poshtë. [Shiko më shumë.](#)

Ne ju inkurajojmë të lexoni të plotë **Politikën tonë të Privatësisë** dhe **Cookies** më poshtë për të kuptuar në thellësi mënyrën se si ne do të përdorim të dhënat tuaja personale dhe të drejtat mbi të dhënat tuaja.

PARA SE TË FILLONI ...

- Në këtë **Politikë të Privatësisë dhe Cookies**, ju do të gjeni të **gjitha informacionet përkatëse** të zbatueshme për përdorimin tonë të të dhënave personale të përdoruesve dhe klientëve tanë, **pavarësisht nga kanali ose mjetet (në internet ose personalisht)** i ZARA në Kosovë që ju përdorni për të bashkëvepruar me ne.
- Nëse dëshironi informacion në lidhje me mënyrën se si ne përdorim Cookies dhe pajisje të ngjashme që mund të instalohen në терминаlet e klientëve dhe përdoruesve tanë, ju rekomandojmë që të konsultoheni me Politikën e Cookies.
- **Ne jemi transparentë** për atë që bëjmë me të dhënat tuaja personale, për t'ju ndihmuar të kuptoni implikimet e mënyrës se si ne përdorim të dhënat tuaja, dhe të drejtat që ju keni në lidhje me të dhënat tuaja:
 - Ne **vendosim** në dispozicion të përhershëm të gjitha informacionet e përfshira në këtë Politikë të Privatësisë dhe Cookies, të cilën mund ta kontrolloni kur e konsideroni të përshtatshme, dhe përveç kësaj,
 - ju gjithashtu do të gjeni **informacione të mëtejshme** se si ne i përdorim të dhënat tuaja **ndërsa bashkëveproni me ne**.
- Këto janë disa terma që ne përdorim rregullisht në këtë Politikë të Privatësisë dhe Cookies:
 - Kur flasim për **Platformën**, tonë, ne i referohemi, në përgjithësi, cilitdo prej kanaleve ose mjeteve, qoftë dixhitale ose personalisht që ju mund të keni përdorur për të bashkëvepruar me ne. Kryesorët janë:
 - Faqja jonë e internetit.
 - **Aplikacioni**, që do të thotë, përfshirë si aplikacionin celular që keni instaluar në pajisjen tuaj po ashtu edhe aplikacionet e tjera që ne përdorim në Platformën tonë.
 - Personalisht, në cilindo prej **dyqaneve tona fizike në Shqipëri**.

1. KUSH ËSHTË KONTROLLUESI I TË DHËNAVE TUAJA?

Kontrolluesit e të dhënave tuaja janë:

- **ITX ALBANIA SHPK**, kompani që aktualisht ushtron në Shqipëri aktivitetin e shitjes së produkteve të markës ZARA ("ZARA SHQIPËRI"):
 - Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Dervish Hima", ndërtesa Ambasador 3, Kati i 11, Nr. 86, Nr. 87, Tiranë, Shqipëri.
 - E-mail i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave: dataprotection@zara.com
- **INDUSTRIA DE DISEÑO TEXTIL, S.A.** (INDITEX, S.A.), S.A. ("INDITEX"):
 - Njësia Bashkiake Nr. Avda. de la Diputación, Edificio Inditex, 15143, Arteixo (A Coruña), Spanjë.
 - E-mail i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave: dataprotection@zara.com

Me fjalë të tjera, si ZARA SHQIPËRI ashtu dhe INDITEX (bashkërisht "Ne", "Neve" ose "Bashkë-kontrolluesit"), jemi **Bashkë-kontrollues** të të dhënave. Kjo do të thotë që ne kemi rregulluar dhe jemi bashkërisht përgjegjës për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja personale.

2. PËRSE I PËRPUNOJMË TË DHËNAT TUAJA PERSONALE?

Në varësi të qëllimit për të cilin ne përpunojmë të dhënat tuaja herë pas here, siç shpjegohet më poshtë, ne duhet të përpunojmë një ose të dhëna të tjera, të cilat në përgjithësi do të jenë, **në varësi të secilit rast**, si më poshtë:

- **të dhënat** e identitetit tuaj (për shembull, emrin, mbiemrin, imazhin, gjuhën dhe tregun nga i cili ju bashkëveproni me ne, të dhënat e kontaktit, etj.);
- **informacioni ekonomik dhe** transaksionet (për shembull, të dhënat e pagesës ose kartës tuaj, informacione mbi blerjet, porositë, kthimet, etj.);
- **të dhëna mbi** lidhjen e internetit, **vendndodhjen gjeografike dhe/ose historikun e lundrimit** (për shembull: të dhënat e vendodhjes suaj, numrin identifikues të pajisjes, kodin identifikues të reklamës etj);
- informacioni komercial (për shembull, nëse jeni abonuar për buletin tonë),
- informacioni në lidhje me **shijet dhe preferencat tuaja**.

Mos harroni se, kur ne ju kërkojmë të plotësoni të dhënat tuaja personale për t'ju dhënë mundësinë e përdorimit të ndonjë funksionaliteti ose shërbimi të Platformës, ne do të shënojmë fusha të caktuara si *të detyrueshme*, pasi ky është informacioni që na nevojitet që të jemi në gjendje të sigurojmë shërbimin ose për t'ju dhënë qasje në funksionalitetin në fjalë. Ju lutemi kini parasysh që, nëse zgjedhni që të dhënat e tilla të mos i vendosni në dispozicion për ne, ju mund të mos jeni në gjendje të përfundoni regjistrimin e përdoruesit ose mund të mos jeni në gjendje të gëzoni ato shërbime ose funksionalitete.

Në raste specifike, një palë e tretë mund të na ketë dhënë informacione rreth jush duke përdorur një funksionalitet ose shërbim në Platformë, për shembull, duke ju dërguar një kartë dhurate ose duke ju dërguar një porosi në adresën tuaj. Në këto raste, ne i përpunojmë të dhënat tuaja vetëm kur janë të rëndësishme për këtë funksionalitet ose shërbim, siç përshkruhet në këtë Politikë të Privatësisë dhe Kuki.

Cookies të shfaqura gjatë lundrimit tuaj dhe teknologji të tjera të ngjashme në Platformën tonë apo në komunikimet që ne dërgojmë.

Në varësi të mënyrës se si bashkëveproni me Platformën tonë, d.m.th., në varësi të shërbimeve, produkteve ose funksionaliteteve që dëshironi të shijoni, ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale për qëllimet e mëposhtme:

QËLLIMI	+ info
1. Për të menaxhuar regjistrimin tuaj si përdorues në Platformë	<p>Nëse vendosni të bëheni përdorues i regjistruar i Platformës sonë, ne duhet ta përpunojmë të dhënat tuaja për t'ju identifikuar si përdorues të Platformës dhe ofruar ju qasje në funksionalitete, produkte dhe shërbime të ndryshme në dispozicion për ju si përdorues i regjistruar. Ju mund të anuloni llogarinë tuaj të regjistruar të përdoruesit duke na kontaktuar përmes Shërbimit të Klientit.</p> <p>Me anë të kësaj ju informojmë se të dhënat që mbledhim në lidhje me aktivitetin tuaj, të cilat janë mbledhur përmes kanaleve të ndryshme të Platformës dhe që përfshijnë blerjet tuaja, do të mbeten të lidhura me llogarinë tuaj, në mënyrë që të gjitha informacionet të mund të arrihen së bashku.</p>
2. Për realizimin, kryerjen dhe ekzekutimin e kontratës së shitblerjes ose shërbimeve që ju keni ekzekutuar me Ne në Platformë	<p>Ky qëllim përfshin përpunimin e të dhënave tuaja, kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none">• Për t'ju kontaktuar për përditësime ose njoftime informative të lidhura me funksionalitetet, produktet ose shërbimet e kontraktuara, përfshirë anketat e cilësisë dhe për të qenë në gjendje të caktojme një shkallë të kënaqësisë të klientit që i ofrohet shërbimin;

QËLLIMI	+ info
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për të menaxhuar pagesën e produkteve që ju blini, pavarësisht procedurës së ndjekur të pagesës. Për shembull: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nëse gjatë blerjes së ndonjë prej produkteve tona përmes faqes së internetit ose aplikacionit, vendosni të aktivizoni funksionalitetin e ruajtjes së të dhënave të pagesës dhe adresës suaj postare për blerjet e ardhshme (kur ky funksionalitet është i disponueshëm), ne duhet të përpunojmë të dhënat e treguara për aktivizimin dhe zhvillimin e këtij funksionaliteti. Pëlqimi për aktivizimin e këtij funksionaliteti mundëson që të dhënat tuaja të plotësuara automatikisht të pagesës të shfaqen në blerjet pasuese, në mënyrë që të mos keni nevojë t'i futni ato në çdo proces të ri, dhe këto të dhëna do të konsiderohen të vlefshme dhe efektive për blerjet pasuese. Ju mund të ndryshoni ose anuloni të dhënat e pagesës suaj në çdo kohë përmes seksionit të informacionit të pagesës në llogarinë tuaj të përdoruesit të regjistruar në faqen e internetit ose në seksionin Llogaria ime të aplikacionit.. ▪ Aktivizoni mekanizmat e nevojshëm për të parandaluar dhe identifikuar përdorimet e pa-autorizuara të Platformës (për shembull, gjatë procesit të blerjes dhe kthimeve) si dhe mashttrimet të mundshme të kryera ndaj jush dhe/ose ndaj nesh. Nëse vlerësojmë se transaksioni i kryer mund të jetë mashttrim ose nëse dallojmë sjellje jo-normale që tregon përpjekje për përdorim me mashttrim të funksionaliteteve, produkteve ose shërbimeve tona, ky përpunim mund të rezultojë në pasoja të tilla si bllokimi i transaksionit ose fshirja e llogarisë tuaj të përdoruesit. ▪ Për të menaxhuar shkëmbimet ose kthimet e mundshme pas blerjes dhe për të menaxhuar kërkesat e informacionit për disponueshmërinë e artikujve, në varësi të disponueshmërisë së mundësive të tilla herë pas here. ▪ Për qëllime të faturimit dhe për t'ju vënë në dispozicion biletat dhe faturat e blerjeve që i keni bërë përmes Platformës. ▪ Për t'u siguruar që ju jeni në gjendje të përdorni funksionalitete ose shërbime të tjera në dispozicion, të tilla si blerje, marrje, menaxhim dhe përdorim të Kartës së dhuratave, dhe për t'ju dhënë akses dhe përdorim të Wi-Fi që ne ofrojmë për klientët tanë në dyqanet fizike. ▪ Për t'ju mundësuar nëpërmjet aplikacionit, shërbime specifike (si gjej produktin, prenoto dhomën e provës, etj) që ofrohen në disa nga dyqanet tona fizike, në këtë rast ne mund të përdorim vendndodhjen tuaj dhe të dhënat e kontaktit.
<p>3. Për të përmbushur kërkesat e aplikimeve që ju bëni përmes kanaleve të Mbështetjes së Klientit</p>	<p>Ne përpunojmë vetëm të dhënat personale që janë kategorikisht të nevojshme për të menaxhuar ose zgjidhur kërkesën tuaj të aplikimit.</p> <p>Nëse na kontaktoni përmes telefonit, telefonata mund të regjistrohet për qëllime cilësie dhe që të mund t'i përgjigjemi kërkesës tuaj.</p> <p>Nëse është i disponueshëm dhe ju vendosni të përdorni WhatsApp-in si kanal komunikimi me përfaqësuesit e Ndihmës ndaj Klientit, ne do të ndajmë numrin tuaj të telefonit me WhatsApp Inc. (një kompani e vendosur në SH.B.A.) për të konfirmuar që ju jeni përdorues i këtij shërbimi. Ju rekomandojmë të rishikoni cilësimet tuaja të privatësisë dhe të lexoni politikën e privatësisë së WhatsApp-it për të marrë informacion më të detajuar në lidhje</p>

QËLLIMI	+ info
	<p>me përdorimin që WhatsApp-i u bënë të dhënave personale të përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e tyre.</p> <p>Nëse është i disponueshëm dhe ju vendosni të komunikoni me përfaqësues të Ndhmës ndaj Klientit përmes shërbimit chat të një rrjeti social ose nëpërmjet një bashkëpunëtori tjetër, disa nga të dhënat tuaja personale, si emri juaj ose emri i përdoruesit, do të merren nga llogaria juaj personale në rrjetin social të përzgjedhur ose llogaria e bashkëpunëtorit. Gjithashtu, mbani ndër mend se të dhënat që ju paraqisni në këtë shërbim do të jenë në dispozicion të rrjetit tuaj social ose bashkëpunëtorit tuaj dhe do tu nënshtrohen politikave të tyre të privatësisë, prandaj ju rekomandojmë që të rishikoni cilësimet tuaja të privatësisë dhe të lexoni politikat e privatësisë të rrjetit social ose bashkëpunëtorit në fjalë, për t'u informuar në mënyrë më të hollësishme rreth përpunimit të të dhënave tuaja personale gjatë përdorimit të shërbimit të tyre.</p>
<p>4. Për qëllime marketingu.</p>	<p>Ky qëllim përfshin përpunimin e të dhënave tuaja, kryesisht, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Personalizoni shërbimet që ne ju ofrojmë dhe na lejoni t'ju japim rekomandime bazuar në ndërvëprimin tuaj me ne në Platformë dhe një analizë të profilit tuaj të përdoruesit (për shembull, bazuar në historinë tuaj të blerjes dhe shfletimit). ▪ Nëse dhe kur ju abonoheni për Buletinin, ne do të përpunojmë të dhënat tuaja personale për të menaxhuar abonimin tuaj, përfshirë, dërgimin e informacionit të personalizuar për produktet shërbimet nëpërmjet mjeteve të ndryshme (të tilla si e-mail ose SMS). Ne gjithashtu mund t'ju mundësojmë këto informacione përmes njoftimeve të automatizuara në rast se i keni aktivizuar ato në pajisjen tuaj celular. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Për sa më sipër, ju lutemi kini parasysh që ky përpunim i të dhënave nënkupton analizën e profilit tuaj të përdoruesit ose klientit për të caktuar preferencat tuaja dhe për këtë cilat produkte dhe shërbime janë më të përshtatshme për stilin tuaj kur ju dërgojnë informacione. Për shembull, bazuar në blerjet tuaja dhe historinë e shfletimit (d.m.th., në varësi të artikujve që keni klikuar), ne do t'ju bëjmë sugjerime për produkte për të cilat besojmë se mund t'ju interesojnë dhe nëse jeni përdorues i regjistruar, ne do t'ju ofrojmë funksionalitetin "rimerr karrocën". ▪ Kini parasysh që ju mund të çabonoheni nga Buletini në çdo kohë pa kosto përmes seksionit "Buletini" i Platformës, përveç udhëzimeve që ju ofrojmë në secilin njoftim. Nëse nuk doni të merrni njoftime të automatizuara, ju mund ta deaktivizoni këtë opsion në pajisjen tuaj mobile. ▪ Do t'ju tregojmë reklama në internet, të cilat mund t'i shihni kur vizitoni faqe interneti dhe aplikacione, për shembull, në mediat sociale. Reklamat që shihni mund të jenë rastësore, por në raste të tjera, këto reklama mund të lidhen me preferencat ose historinë tuaj të blerjes dhe shfletimit. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nëse përdorni mediat sociale, ne mund t'u japim kompanive me të cilat bashkëpunojmë, informacione të caktuara në mënyrë që ata t'ju tregojnë reklama të markës sonë dhe, në përgjithësi, t'ju shfaqim juve dhe përdoruesve si ju, reklama që marrin parasysh profilin tuaj

QËLLIMI	+ info
	<p>në faqet e përmendura të mediave sociale. Nëse dëshironi informacion rreth përdorimit të të dhënave tuaja dhe mënyrën se si funksionon reklamimi në mediat sociale, ju rekomandojmë të shqyrtoni politikat e privatësisë së faqeve të mediave sociale në të cilat keni profile.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ne gjithashtu përdorim të dhënat tuaja për të kryer matje dhe analiza të segmenteve në reklamat që u tregojmë përdoruesve në disa prej platformave të bashkëpunëtorëve tanë. Për ta bërë këtë, ne bashkëpunojmë me këta palë të treta që na ofrojnë teknologjinë e nevojshme (për shembull, kuki, kodet, SDK) për të përdorur këto shërbime. Mbani mend se, megjithëse ne nuk u japim të dhëna personale identifikuese këtyre bashkëpunëtorëve, ne u japim atyre një lloj identifikimi çdo herë (për shembull, ID e reklamimit të lidhur me pajisjen, një identifikues të lidhur me një kuki, etj.) Nëse dëshironi më shumë informacione në lidhje me këtë, ju lutemi shqyrtoni Politikën tonë të kuki. Në të njëjtën mënyrë, ju mund të resetoni ID tuaj të reklamave ose të çaktivizoni reklamat e personalizuara në pajisjen tuaj, duke modifikuar preferencat e zgjedhura në seksionin e opsioneve të pajisjes suaj. ▪ Ndërthurja e të dhënave: Kur mbledhim të dhënat tuaja personale nga burime të ndryshme, ne mund t'i konsolidojmë ato në rrethana të caktuara për qëllime të përmirësimit të të kuptuarit tonë të nevojave dhe preferencave tuaja në lidhje me produktet dhe shërbimet tona (duke përfshirë qëllime të analizimit, gjenerimin e profileve të përdoruesve, studime të marketingut, sondazhe të cilësisë dhe përmirësimit të ndërveprimeve tona me klientët tanë). Kjo i referohet, për shembull, mënyrës sesi ne mund të kombinojmë informacionin tuaj nëse keni një llogari të regjistruar dhe, duke përdorur të njëjtën adresë email të lidhur me llogarinë tuaj, ju bëni një blerje si mysafir, ose informacionit që përpilohet automatikisht (siç është IP dhe adresa MAC ose metadata) të cilat mund t'i lidhim me informacionin që ju na keni dhënë drejtpërsëdrejti përmes veprimtarisë suaj në Platformë ose në ndonjë prej dyqaneve tona (për shembull, informacione që lidhen me blerjet tuaja, qoftë në dyqane fizike ose në internet, preferencat tuaja, etj). ▪ Për të ndërmarrë veprime promovionale (për shembull, për organizimin e konkurseve ose për të dërguar listën e artikujve të ruajtura, ose vetëm një artikull, në postën elektronike që ju caktoni). Kur merrni pjesë në ndonjë aktivitet promovional, ju na autorizoni të përpunojmë të dhënat personale që keni ndarë me ne në varësi të veprimit promovional dhe t'i shpalosim ato përmes mediave të ndryshme siç janë rrjetet sociale ose vetë Platforma. Në secilin aktivitet promovional në të cilin ju merrni pjesë, do të keni në dispozicion termat dhe kushtet ku ne do t'ju ofrojmë informacion më të detajuar në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale. ▪ Për të shpërndarë në Platformë ose përmes kanaleve tona në rrjetet sociale fotografi ose imazhe që keni shpërndarë publikisht, me kusht që ju të na jepni shprehimisht pëlqimin tuaj për qëllimin.
<p>5. Analiza mbi përdorshmërinë dhe cilësinë</p>	<p>Nëse keni qasje në Platformë, ju informojmë që do t'i trajtojmë të dhënat tuaja të shfletimit për qëllime analitike dhe statistikore, pra për të kuptuar mënyrën se si përdoruesit bashkëveprojnë me Platformën tonë dhe me</p>

QËLLIMI	+ info
për të përmirësuar shërbimet tona	<p>veprimet që ne kryejmë në aplikacione dhe faqe të tjera interneti, në mënyrë që të mund të përmirësojmë shërbimet tona.</p> <p>Përveç kësaj, ne nganjëherë kryejmë anketa vlerësimi të cilësisë dhe aktivitete që të njohim shkallën e kënaqësisë së klientëve tanë dhe përdoruesve dhe të zbulojmë ato zona ku mund të përmirësohemi.</p>

3. SI LEJOHEMI LIGJËRISHT QË TË PËRPUNOJMË TË DHËNAT TUAJA?

Kushtet ligjore mbi të cilat na lejohe të përpunojmë të dhënat tuaja personale varen edhe nga qëllimi për të cilin i përpunojmë, siç shpjegohet në tabelën e mëposhtme:

Qëllimi	Statusi ligjor
<p>1. Për të menaxhuar regjistrimin tuaj të përdoruesit në Platformë</p>	<p>Ne menaxhojmë të dhënat tuaja sepse është e nevojshme për termat që rregullojnë përdorimin e Platformës. Me fjalë të tjera, në mënyrë që ju të regjistroheni si përdorues në Platformë, ne duhet të përpunojmë të dhënat tuaja personale, pasi përndryshe nuk do të ishim në gjendje të menaxhoni regjistrimin tuaj.</p> <p>Ne konsiderojmë se kemi një interes të ligjshëm për të lidhur me llogarinë tuaj blerjet tuaja dhe të dhënat e mbledhura përmes kanaleve të ndryshme të Platformës në lidhje me aktivitetin tuaj.</p>
<p>2. Realizimi, zbatimi dhe lidhja e kontratës për shitblerje ose shërbimeve.</p>	<p>Ne përpunojmë të dhënat tuaja për arsye se kjo na nevojitet për të bërë kontratën e blerjes ose të shërbimeve me ju.</p> <p>Ky përpunim i caktuar i të dhënave në lidhje me procesin e blerjes ndodh vetëm sepse ju i kërkonit ose e autorizoni atë, siç është rasti i ruajtjes së të dhënave të pagesës (kartës) për blerjet e ardhshme ose për t'ju ofruar funksionalitete Vjen Së Shpejti/ Rikthehet Së Shpejti (kur këto funksionalitete janë në dispozicion). Në këto raste, përpunimi ynë i të dhënave tuaja bëhet me vet pëlqimin tuaj. Përveç kësaj, me pëlqimin tuaj, përpunojmë të dhënat e vendndodhjes suaj, në mënyrë që t'ju ofrojmë shërbime specifike përmes aplikacionit kur vizitoni disa nga dyqanet tona fizike.</p> <p>Konsiderojmë se kemi një interes legjitim për të kryer verifikimet e nevojshme për të zbuluar dhe parandaluar mashtrimet e mundshme ose përdorimet mashtruese të Platformës, për shembull kur bëni një blerje ose kthim ose për të analizuar efikasitetin e disa shërbimeve të përfshira në Platformë, të tilla si për shembull, mjeti Rekomandues i Masës. Ne e kuptojmë që përpunimi i këtyre të dhënave është në të mirë të të gjitha palëve të përfshira: për ju, pasi na lejon që të ndërmarrim masa për t'ju mbrojtur nga përpjekje të palëve të treta për mashtrim; për Ne, pasi na lejon që të shmangim përdorimin e paautorizuar të Platformës; për të gjithë klientët tanë dhe shoqërinë, pasi mbron edhe interesin e tyre, duke siguruar dekurajimin e aktiviteteve mashtruese dhe identifikimin e tyre kur ndodhin.</p>
<p>3. Shërbimi i Klientit</p>	<p>Ne konsiderojmë se kemi interes legjitim për t'iu përgjigjur kërkesave ose pyetjeve të ngritura nga ju përmes kanaleve të ndryshme ekzistuese të kontaktit. Ne e kuptojmë që përpunimi i këtyre të dhënave është gjithashtu i dobishëm për ju deri në atë masë sa na mundëson t'ju ofrojmë ndihmën e duhur dhe t'iu përgjigjemi për pyetjet e ngritura.</p> <p>Kur kontaktoni me ne, në veçanti, për menaxhimin e incidenteve në lidhje me porosinë tuaj ose produktin/shërbimin e marrë përmes Platformës, përpunimi i të dhënave tuaja nevojitet për të kryer kontratën e shitblerjes.</p> <p>Kur kërkesa juaj ka të bëjë me ushtrimin e të drejtave tuaja për të cilat do t'ju informojmë më poshtë, ose për pretendime që lidhen me produktet ose shërbimet tona, ne na lejohe ligjërisht t'i përpunojmë të dhënat tuaja në përputhje me detyrimet tona ligjore.</p>

Qëllimi	Statusi ligjor
<p>4. Marketingu</p>	<p>Ne na lejohet ligjërisht që të përpunojmë të dhënat tuaja për qëllime të marketingut për shkak të pëlqimit që ju na jepni, për shembull kur pranoni të merrni informacione të personalizuara përmes kanaleve të shumta, kur pranoni dërgimin e njoftimeve të automatizuara në pajisjen tuaj celular ose kur konfiguroni cilësimet e pajisjes tuaj duke e aktivizuar atë në opsionet e privatësisë së pajisjes së përdorur, kur e autorizoni nëpërmjet opsioneve të Cookies, ose kur pranoni termat dhe kushtet ligjore për të marrë pjesë në një fushatë promovionale ose për të publikuar fotot tuaja në Platformë ose në kanalet e rrjeteve tona sociale.</p> <p>Për t'ju ofruar shërbime të personalizuara ose për t'ju treguar informacion të personalizuar, qoftë në Platformën tonë ose në ato të palëve të treta, si dhe për t'u angazhuar me ndërthurjen e të dhënave, ne konsiderojmë se kemi një interes të ligjshëm të bëjmë një profilizim me informacionin që kemi për ju (të tilla si historia e shfletimit, preferencave ose blerjeve) dhe të dhënat personale që na keni dhënë, të tilla si grupmosha ose gjuha, pasi ne e kuptojmë se përpunimi i të dhënave të tilla është gjithashtu i dobishëm për ju sepse ju lejon të përmirësoni përvojën tuaj të përdoruesit dhe të aksesoni informacionin sipas preferencave tuaja.</p>
<p>5. Analiza e përdorimit dhe cilësisë</p>	<p>Ne konsiderojmë se kemi interes të ligjshëm për të analizuar përdorimin e Platformës dhe shkallën e kënaqësisë së përdoruesit, pasi ne kuptojmë që përpunimi i këtyre të dhënave është gjithashtu i dobishëm për ju sepse qëllimi është të përmirësojmë përvojën e përdoruesit dhe të ofrojmë një shërbim të cilësisë së lartë.</p>

4. SA KOHË DO TË I MBAJMË TË DHËNAT TUAJA?

Koha e mbajtjes së të dhënave tuaja do të varet nga qëllimet për të cilat i përpunojmë, siç shpjegohet më poshtë:

Qëllimi	Koha e mbajtjes së të dhënave tuaja
1. Për të menaxhuar regjistrimin tuaj të përdoruesit në Platformë	Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja për kohën gjatë së cilës ju mbeteni një përdorues i regjistruar (që do të thotë, derisa të vendosni të çabonoheni).
2. Zhvillimi, kryerja dhe ekzekutimi i kontratës së blerjes ose shërbimeve	Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja për kohën që nevojitet për të menaxhuar blerjen e produkteve ose shërbimeve që blini, përfshirë kthimet e mundshme, ankesat ose pretendimet që lidhen me blerjen e produktit ose shërbimit në fjalë. Ndonjëherë, ne do t'i përpunojmë të dhënat vetëm për kohën që ju caktoni, siç është rasti i të dhënave të pagesës (kartës) që na keni kërkuar për t'i ruajtur për blerjet e ardhshme (kur ky funksionalitet është në dispozicion).
3. Shërbimi i Klientit	Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja për kohën e nevojshme për të përmbushur kërkesën ose aplikimin tuaj.
4. Marketingu	Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja derisa të çabonoheni ose anuloni abonimi tuaj për buletin. Po kështu, do t'ju tregojmë reklama të personalizuara derisa të ndryshoni cilësimet e pajisjes, shfletuesit dhe/ose Cookies në mënyrë që të hiqet leja për ta bërë këtë. Nëse merrni pjesë në fushata promovionale, ne do t'i ruajmë të dhënat për një periudhë gjashtë (6) mujore nga mbarimi i fushatës.
5. Analiza e përdorimit dhe cilësisë	Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja herë pas here për kohën gjatë së cilës ne vazhdojmë të ndërmarrim një veprim ose studim specifik për cilësinë ose derisa t'i anonimizojmë të dhënat tuaja të shfletimit.

Pavarësisht nga fakti se ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja për kohën në mënyrë rigoroze, të domosdoshme për të arritur qëllimin në fjalë, ne do t'i ruajmë dhe mbrojmë më pas në mënyrën e duhur për kohën gjatë së cilës mund të lindë përgjegjësia për përpunimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi herë pas here. Sapo të kalojë koha e secilës fushatë të mundshme, ne do të vijojmë me fshirjen e të dhënave personale.

5. A I NDAJMË TË DHËNAT TUAJA ME PALË TË TRETA?

Për të arritur qëllimet e përmendura në këtë Politikë Privatësie dhe të Cookies, ne duhet të japim qasje në të dhënat tuaja personale **subjekteve të Inditex Group** dhe **palëve të treta** që na ofrojnë mbështetje në shërbimet që ne ju ofrojmë, p.sh.:

- **institucioneve** financiare,
- **zbulimin kundër mashtrimeve**, dhe parandalimin e subjekteve,
- ofruesve të shërbimeve teknologjike dhe analitike,
- ofruesit dhe partnerët e shërbimeve në lidhje me **logjistikën**, **transportin** dhe **dorëzimin** dhe/ose organizatat partnere të tyre,

- ofruesve të shërbimeve që lidhen me mbështetje të klientëve,
- ofruesit e shërbimeve dhe bashkëpunuesit në lidhje me **marketingun dhe publicitetin**, të tilla si faqet e mediave sociale, agjencitë e reklamave ose partnerët e reklamave.

Për qëllime të efikasitetit të shërbimeve, disa prej këtyre ofruesve janë të vendosur në territoret jashtë Zonës Ekonomike Evropiane që nuk ofrojnë një nivel të mbrojtjes së të dhënave krahasuar me atë të Bashkimit Evropian, të tilla si Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në rast të tilla, ne ju informojmë se do t'i transferojmë të dhënat tuaja me **masa mbrojtëse të përshtatshme dhe gjithmonë do t'i ruajmë të dhënat tuaja të sigurt** duke përdorur mjetet më të përshtatshme për transferimin ndërkombëtar të të dhënave, siç përmendet në klauzolat standarde të kontratës dhe çdo masë tjetër shtesë. Ju mund të konsultoheni me përmbajtjen e këtyre klauzolave kontraktuale përmes linkut në vijim: https://ec.europa.eu/info/law/law-topic/data-protection/data-transfers-outside-eu/model-contracts-transfer-personal-data-third-countries_en

Për më tepër, në rast të ndonjë të dhëne direkte nga Shqipëria drejt vendit që nuk listohet nga Komisioneri Shqiptar për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave (më tej “DPA”) si vend i sigurt, transferimi përkatës do të ndodhë vetëm pasi të keni marrë miratimet përkatëse për një transferim të tillë nga DPA.

Në rast se shesim ose transferojmë të gjithë ose një pjesë të biznesit ose pasurive tona tek një kompani tjetër brenda ose jashtë Grupit Inditex, ose kemi ndonjë operacion tjetër biznesi të zbatuar si pasojë e riorganizimeve të korporatave, ne mund t'i vendosim të dhënat tuaja personale në dispozicion të zotëruesit pasardhës të biznesit ose pasurive të tilla. Nëse ndodh një shitje ose transferim i tillë, ne do të bëjmë gjithçka që kemi në dorë për tu kujdesur që përdorimi i mëtejshëm i të dhënave personale që na keni besuar të jetë në përputhje me Politikën tonë të Privatësisë dhe Cookies. Në këtë rast, ne konsiderojmë se kemi interes të ligjshëm që konsiston në riorganizimin e strukturës sonë të korporatave.

Për më tepër, nëse vendosni të përdorni Platformën në tregje të ndryshme (p.sh. duke krijuar llogari të përdoruesve të regjistruar në tregje të ndryshme me të njëjtën adresë e-maili), mund të na duhet të ndajmë ose të transferojmë informacionet e lidhura me llogarinë tuaj ose aktivitetin tuaj te kompanitë e markës sonë që operojnë në ato tregje, në masën që ato përfshihen drejtpërdrejt në arritjen e ndonjë prej qëllimeve të përshkruara në seksionin 2. Ne e konsiderojmë këtë të nevojshme në përputhje me interesat dhe preferencat tona të ndërsjella.

6. ÇFARË JANË TË DHËNAT TUAJA KUR I VENDOSNI NË DISPOZICIONIN TONË?

Ne ndërmarrim masa për t'i ruajtur të dhënat tuaja personale konfidenciale dhe për t'ju siguruar se mund të **ushtroni e të drejtat tuaja**. Kini parasysh që ne, Kontrolluesit e Përbashkët kemi rënë dakord që ju të mund të ushtroni të drejtat tuaja **pa pagesë** duke na shkruar **një e-mail në një adresë të vetme** (dataprotection@zara.com), thjesht duke na informuar për arsyen e kërkesës tuaj dhe të drejtën që dëshironi të ushtroni. Nëse e konsiderojmë të nevojshme për të qenë në gjendje t'ju identifikojmë, mund t'ju kërkojmë të siguronit një kopje të një dokumenti që dëshmon identitetin tuaj.

Për më tepër, Ne mund t'ju ofrojmë mundësinë për të ushtruar të drejtat tuaja dhe vendosjen e preferencave tuaja të privatësisë kur përdorni disa nga shërbimet tona, ose duke ju vënë në dispozicion kanale specifike brenda Platformës sonë.

Në veçanti, pavarësisht qëllimit ose bazës ligjore që ne përdorim për të përpunuar të dhënat tuaja, ju keni këto të drejta:

- Të kërkonti **qasje** në të dhënat tuaja personale që ne mbajmë. Ju kujtojmë që atje ku jeni një përdorues i regjistruar në Platformë, gjithashtu mund të konsultoheni me këto informacione në seksionin përkatës të llogarisë tuaj në internet. Ju keni të drejtë të merrni të gjitha informacionet mbi të dhënat tuaja personale ose shpjegimin pse ky informacion nuk mund të sigurohet, brenda 30 ditësh nga momenti i pranimit të kërkesës për qasjen në informacione.

- Të na kërkoni **ndryshimin** e të dhënave personale që ne mbajmë. Ju lutemi kini parasysh se nëse jeni një përdorues i regjistruar në Platformë, mund të përdorni gjithashtu seksionin përkatës të të dhënave personale të llogarisë tuaj në internet për të ndryshuar ose përditësuar të dhënat tuaja personale. Në çdo rast, ju lutemi kini parasysh që, duke i vendosur qëllimisht të dhënat tuaja personale në dispozicion tonë sipas cilësdo procedure, ju garantoni se ato janë **të vërteta dhe të sakta** dhe merrni përsipër të na njoftoni për çdo ndryshim ose modifikim të të dhënave tuaja. Ju do të jeni përgjegjës për çdo humbje ose dëm të shkaktuar Platformës ose personit përgjegjës për Platformën ose ndonjë pale të tretë nëse raportoni informacione të gabuara, të pasakta ose të paplota në formularët e regjistrimit. Ju lutemi mbani mend se, si rregull i përgjithshëm, ju duhet të na siguroni vetëm të dhënat tuaja, jo me ato të palëve të treta, përveç në masën e lejuar ndryshe në këtë Politikë të Privatësisë dhe Cookies. Ju keni të drejtë të merrni informacionin nëse korrigjimi është kryer apo jo brenda 30 ditësh nga momenti i pranimit të kërkesës për korrigjim, përndryshe keni të drejtë të paraqisni një kërkesë pranë Komisionerit Shqiptar për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave.
- Të na kërkoni që t'i **fshijmë** të dhënat tuaja personale në atë masë sa ato nuk janë më të domosdoshme për qëllimin për të cilin duhet të vazhdojmë t'i përpunojmë ato, siç e kemi shpjeguar më lart, ose kur nuk na lejohet më ligjërisht t'i përpunojmë ato. Ju keni të drejtë ta merrni informacionin nëse fshirja është kryer apo jo brenda 30 ditësh nga momenti i pranimit të kërkesës së fshirjes, përndryshe keni të drejtë të paraqisni një kërkesë pranë Komisionerit Shqiptar për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave.
- Të na kërkoni që të **fshijmë ose kufizojmë përpunimin** e të dhënave tuaja personale, që nënkupton që në raste të caktuara, mund të kërkoni nga ne që të pezullojmë përkohësisht përpunimin e të dhënave ose që ne t'i mbajmë ato më gjatë seç duhet.

Nëse na keni dhënë **pëlqimin** për të përpunuar të dhënat tuaja për ndonjë qëllim, ju **keni gjithashtu të drejtë të tërhiqni këtë pëlqim në çdo kohë**. Disa nga rrethanat në të cilat ju mund të tërhiqni pëlqimin tuaj janë të detajuara në seksionin 2, ku ne shpjegojmë për cilat qëllime ne përpunojmë të dhënat tuaja.

Nëse nuk dëshironi që të dërgojmë informacione te palët e treta për t'ju shfaqur reklama, mund ta bëni përmes disa mënyrave të tilla si ndryshimi i opsioneve të aktivizuara në pajisjen tuaj, duke ndryshuar cilësimet në motorin tuaj të kërkimit dhe/ose Cookies, duke rishikuar politikat e privatësisë dhe cilësimet e faqeve të mediave sociale në të cilat keni profile ose duke na dërguar një e-mail në adresën e lartpërmendur të e-mailit duke na informuar mbi kërkesën tuaj. .

Kur na lejohet ligjërisht që të përpunojmë të dhënat tuaja për shkak të **pëlqimit** ose për qëllime **të kontratës**, siç shpjegohet në seksionin 3, ju gjithashtu do të keni të drejtë të kërkoni **bartjen e të dhënave tuaja personale**. Kjo do të thotë që ju do të keni të drejtë të merrni të dhënat personale që na i keni vënë në dispozicion të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makineritë, për të qenë në gjendje t'i transmetoni ato tek një subjekt tjetër drejtpërsëdrejti, pa pengesa nga ana jonë.

Përveç kësaj, kur përpunimi i të dhënave tuaja bazohet në **interesat tona legjitime**, ju gjithashtu do të keni të drejtë **të kundërshtoni** përpunimin e të dhënave tuaja.

Së fundmi, ne ju informojmë se ju keni të drejtë të paraqisni një kërkesë përpara **autoritetit rregullator**, për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht:

- Autoritetit Spanjoll për Mbrojtjen e të Dhënave (<https://www.agpd.es/portalwebAGPD/index-ides-idphp.php>),
- autoriteti i tregut në të cilin ndodhet shoqëria e shitjeve me pakicë: E Drejta e Informimit dhe Mbrojtja e të Dhënave Shqiptare. (<https://www.idp.al>).

7. ÇFARË NDODH KUR NA JEPNI TË DHËNA TË PALËVE TË TRETË OSE KUR NJË PALË E TRETË NA KA DHËNË TË DHËNAT TUAJA?

Ne ofrojmë funksionalitete ose shërbime që kërkojnë përpunimin e të dhënave personale të një pale të tretë, të cilat ju si përdorues ose klient, duhet të na i siguron, si në rastin e aktivizimit dhe dërgimit të Kartës së dhuratave (kur këto funksionalitete janë të disponueshme), ose kur autorizoni një palë të tretë që të marrë një porosi në dyqanet tona ose në organizatat partnere. Nëse na jepni të dhëna personale të palëve të treta, ose nëse nevojitet që t'i kërkojmë nga një palë e tretë për marrjen e një porosie në emrin tuaj, ju konfirmoni se i keni njoftuar ato për qëllimet dhe mënyrën në të cilën ne kemi nevojë t'i përpunojmë të dhënat e tyre personale.

Nëse një palë e tretë na ka siguruar të dhënat tuaja ose nëse ju i keni siguruar ato vetë si rezultat i një funksionaliteti ose shërbimi të kërkuar nga një prej përdoruesve tanë, ne do t'i përdorim ato për të menaxhuar funksionalitetin ose shërbimin në fjalë në secilin rast, brenda kufijve të qëllimeve të renditura në këtë Politikë të Privatësisë dhe kuki, një lidhje e së cilës përfshihet gjithmonë në komunikimet tona.

8. NDRYSHIMET E PRIVATËSISË DHE NË POLITIKËN E COOKIES

Ne mund të ndryshojmë informacionin e përfshirë në këtë Politikë të Privatësisë dhe Cookies kur e konsiderojmë të përshtatshme. Nëse e bëjmë një gjë të tillë, ne do t'ju njoftojmë me procedura të ndryshme përmes Platformës (për shembull, përmes një posteri, një pop-up ose një njoftim të automatizuar), ose madje mund t'ju dërgojmë një njoftim në adresën tuaj të postës elektronike kur ndryshimi në fjalë është i rëndësishëm për privatësinë tuaj, që ju të mund të rishikoni ndryshimet, t'i vlerësoni ato dhe, sipas rasti, të kundërshtoni ose të çabonoheni nga ndonjë shërbim ose funksionalitet. Në çdo rast, ne ju sugjerojmë të rishikoni herë pas here këtë Politikë të Privatësisë dhe Cookies, në rast se bëhen ndryshime të vogla ose bëjmë ndonjë përmirësim interaktiv, duke shfrytëzuar mundësinë që gjithmonë ta gjeni si një pikë të përhershme informacioni në faqen e internetit dhe aplikacionin tonë.

9. INFORMACION PËR COOKIES

Ne përdorim cookie dhe pajisje të ngjashme për të lehtësuar shfletimin tuaj në Platformë, të kuptojmë se si bashkëveproni me ne dhe, në raste të caktuara, të jemi në gjendje t'ju tregojmë reklama në përputhje me shprehitë tuaja të shfletimit. Ju lutemi të lexoni Politikën tonë të Cookies për të kuptuar më hollësisht Cookie-t dhe pajisjet e ngjashme që ne përdorim, qëllimin e tyre, si të menaxhoni zgjedhjet tuaja si edhe informacione të tjera me interes.

POLITIKA E COOKIES

PARA SE TË FILLOSH...

Në këtë Politikë të Cookies do të gjesh informacione lidhur me mënyrën se si i përdorim cookies dhe skedarë të ngjashëm që instalohen në терминаlet e klientëve dhe përdoruesve tanë. Ndonjëherë, përdorimi i cookies mund të lidhet me përpunimin e të dhënave personale. Për këtë arsye, nëse të duhet informacion për mënyrën se si i përdorim të dhënat personale të klientëve dhe të përdoruesve tanë, për mënyrën se si mund të ushtrosh të drejtat e tua ose për terminologjinë që përdorim për t'iu referuar platformës sonë (ueb, aplikacion ose dyqane fizike), të rekomandojmë të lexosh Politikën e Privatësisë, të disponueshme në platformën tonë.

INFORMACIONE PËR COOKIES

Çfarë është një Cookie?

Cookie është një skedar i vogël teksti që një faqe uebi, aplikacion apo platformë tjetër e ruan në kompjuterin, tabletën, telefonin inteligjent ose çdo pajisje tjetër që ti përdor, i cili përmban informacione rreth shfletimit ose përdorimit të faqeve të internetit, si një etiketë identifikuese e pajisjes sate. Cookies janë të nevojshme, për shembull, për të lehtësuar shfletimin në internet dhe për të kuptuar se si ndërveprojnë përdoruesit me platformat, me qëllim përmirësimin e këtij procesi. Ato janë gjithashtu shumë të rëndësishme për të mundësuar ofrimin e reklamave në bazë të preferencave të përdoruesit, si dhe për qëllime të tjera që do të shtjellohen në vijim. Cookies nuk e dëmtojnë kompjuterin apo pajisjen tënde.

Kur flasim për "Cookies", i referohemi gjithashtu edhe teknologjive të tjera të ngjashme për instalimin dhe/ose mbledhjen e informacioneve në pajisjen tënde ose rreth saj [si flash cookies, web beacons (sinjalizues uebi) apo bugs (defekte në kod), pixels (pikselë), HTML5 (për ruajtjen në njësinë lokale)] dhe teknologjitë SDK për formatet e aplikacioneve. Termi "Cookies" i referohet gjithashtu edhe përdorimit të teknikave të tilla si fingerprinting (shenjat e gishtërinjve), pra atyre teknikave të kombinimit të informacionit që na ndihmon të identifikojmë pajisjen tënde. Në disa raste, këto teknologji bashkëveprojnë me cookies për të mbledhur dhe për të ruajtur informacionin, për të të mundësuar disa funksione ose shërbime të caktuara në platformën tonë, si dhe për të të shfaqur reklama në platformat e palëve të treta, bazuar në shfletimin tënd në internet.

Shpjegimi i mësipërm është një shembull i përgjithshëm i asaj që nënkuptojnë Cookies për qëllime informimi. Cookies që përdorim në mënyrë specifike detajohen në panelin e konfigurimit të cookies, e cila disponohet në platformën tonë.

Cilat janë llojet ekzistuese të Cookies?

Të ftojme të lexosh këtë seksion që ofron një vështrim të përgjithshëm lidhur me llojet e Cookies që mund të përdoren në një mjedis online.

Në bazë të zotëruesit të Cookies, ato mund të klasifikohen në:

- a. Cookies vetjake: Janë ato Cookies që dërgohen në kompjuterin ose pajisjen e përdoruesit nga një pajisje apo domen i menaxhuar nga vetë publikuesi, dhe nga i cili ofrohet platforma apo shërbimi i kërkuar nga përdoruesi.
- b. Cookies nga palë të treta: Janë ato Cookies që dërgohen në kompjuterin ose pajisjen e përdoruesit nga një pajisje apo domen që nuk menaxhohet nga vetë publikuesi, por nga një entitet tjetër që përpunon të dhënat e mbledhura nga cookies.

Në bazë të qëllimeve të Cookies, ato mund të klasifikohen në:

- a. Cookies absolutisht të nevojshme (teknike): Janë ato Cookies që i mundësojnë përdoruesit të shfletojë një faqe interneti, platformë ose aplikacion dhe të përdorë opsionet apo shërbimet e ndryshme që përmbajnë ato. Si për shembull, kontrollin e trafikut, identifikimin e të dhënave apo të sesionit, hyrjen në seksionet apo

përmbajtjet me qasje të kufizuar, memorizimin e elementeve që përbëjnë një porosi, realizimin e procesit të blerjes së një porosie, menaxhimin e pagesës, kontrollin e mashtrimeve që lidhen me sigurinë e shërbimit, përdorimin e elementeve të sigurisë gjatë shfletimit në internet, realizimin e kërkesës për regjistrim apo pjesëmarrje në një ngjarje, regjistrimin e përmbajtjeve për ndarjen e videove apo tingujve, aktivizimin e përmbajtjeve dinamike (për shembull, animimin e ngarkimit të një teksti apo imazhi) ose ndarjen e përmbajtjeve në rrjetet sociale. Cookies teknike, të cilat janë absolutisht të nevojshme, shkarkohen automatikisht kur lejohet shfaqja e platformës ose ofrimi i shërbimit të kërkuar nga përdoruesi.

- b. Cookies funksionale apo personalizimi: Këto Cookies i mundësojnë përdoruesit memorizimin e informacionit për të hyrë në shërbim apo në platformë me karakteristika të caktuara që mund ta ndryshojnë përvojën e tyre nga ajo e përdoruesve të tjerë, si për shembull, gjuha, numri i rezultateve që do të shfaqen kur përdoruesi bën një kërkim, pamja ose përmbajtja e shërbimit në funksion të llojit të shfletuesit të përdoruesit ose të rajonit nga i cili përdoret shërbimi etj. Mospranimi i këtyre Cookies mund të sjellë performancë të ngadaltë të faqes së internetit ose rekomandime të papërshtatura si duhet.
- c. Cookies analitike: Janë ato Cookies që mundësojnë përlogaritjen e numrit të përdoruesve, seksionet e vizituara në platformë dhe mënyrën e ndërveprimit me të, për të bërë matjen dhe analizën statistikore të përdorimit nga ana e përdoruesve, me qëllim përmirësime të ndryshme në funksion të të dhënave të përdorimit nga ana e përdoruesve të platformës apo të shërbimit.
- d. Cookies të reklamimit sipas sjelljes: Janë ato Cookies që ruajnë informacionin e sjelljes së përdoruesve, të përfutur nga vrojtimi i vazhdueshëm i zakoneve të tyre të shfletimit në internet, gjë që mundëson krijimin e një profili specifik për të shfaqur reklama në funksion të vetë këtij profili. Këto Cookies mundësojnë menaxhimin në mënyrën më efikase të mundshme të hapësirave reklamuese, që në rastin e tyre, publikuesi i ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bashkëpunim me palë të treta.

Për çfarë përdoren Cookies në platformën tonë?

Cookies janë një pjesë thelbësore e funksionimit të platformës sonë. Objektivi kryesor i Cookies që përdorim është të të ofrojmë një përvojë më komode dhe efikase gjatë shfletimit në internet. Për shembull, ato përdoren për të memorizuar preferencat e tua (gjuha, vendi etj.) gjatë shfletimit të faqeve të internetit dhe kur i viziton ato sërish. Cookies i përdorim gjithashtu për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe të platformës sonë, si dhe për të mundësuar ofrimin e reklamave të personalizuar sipas zakoneve të tua të shfletimit në internet.

Informacioni i mbledhur në Cookies na mundëson, veç të tjerash, të përmirësojmë platformën tonë duke bërë parashikime rreth të dhënave statistikore dhe modeleve të përdorimit (numri i vizitave, seksionet më të vizituara, kohëzgjatja e vizitës etj.), të kuptojmë në mënyrë statistikore se si ndërveprojnë përdoruesit me platformën, me qëllim përmirësimin e shërbimeve tona, si dhe ta përshtatim platformën sipas interesave të tua individuale, të përshejtojmë kërkimet etj.

Ka raste kur mund t'i përdorim Cookies për të marrë informacione që na mundësojnë të shfaqim platforma të palëve të treta nga platforma jonë, ose në mënyra të tjera, reklama të bazuara në analizën e zakoneve të tua të shfletimit në internet (produktet e vizituara, seksionet ku ke hyrë etj.).

Në çdo rast, në Cookies që përdorim, nuk ruajmë asnjëherë informacione delikate si fjalëkalimet, të dhëna të kartave të kreditit apo të debitit etj.

Si mund ta menaxhoj përdorimin e Cookies në këtë platformë?

Në panelin e konfigurimit të Cookies, i cili disponohet në çdo moment në platformën tonë, mund të marrësh të gjitha informacionet lidhur me Cookies të përdorura nga kjo platformë, së bashku me informacionet që lidhen me qëllimin, kohëzgjatjen dhe menaxhimin (nga ana jote apo nga palë të treta) të secilës prej tyre, për të menaxhuar aktivizimin dhe çaktivizimin e përdorimit të atyre Cookies që nuk janë absolutisht të nevojshme për funksionimin e platformës.

Përndryshe, gjatë kohës që shfleton në internet, mund ta çaktivizosh përdorimin e Cookies në shfletuesin tënd. Më poshtë po paraqesim se si bëhet kjo në shfletuesit më të përdorur:

- [Google Chrome](#)

- [Internet Explorer](#)
- [Mozilla Firefox](#)
- [Safari](#)

Shmangia e përdorimit të Cookies mund të ndërpritet në çdo moment.

Ki parasysht që menaxhimi i panelit të konfigurimit të Cookies, ashtu edhe opsioni i refuzimit të Cookies, është specifik për çdo shfletues që përdor. Për më tepër, nëse zgjedh t'i konfigurosh Cookies në një mënyrë të caktuar në një pajisje dhe dëshiron që të aplikohet i njëjti opsion edhe në një pajisje tjetër, duhet të aktivizosh po atë opsion edhe për pajisjen tjetër.

Për sa i përket Cookies të palëve të treta që synojnë ofrimin e reklamave të bazuara në interesat e tua, ki parasysht se disa palë të treta mund të jenë anëtarë të disa prej programeve vetërregulluese të reklamave sipas sjelljes online, me opsionet përkatëse të përjashtimit vullnetar:

- Network Advertising Initiative (NAI) - <http://www.networkadvertising.org/choices/>
- Google Analytics - <https://tools.google.com/dlpage/gaoptout>

Kush i përdor informacionet e ruajtura në Cookies?

Informacionet e ruajtura në Cookies të platformës sonë përdoren vetëm nga ne, me përjashtim të atyre që specifikohen në paragrafin 2 si "Cookies të palëve të treta", të cilat përdoren dhe menaxhohen nga entitete të jashtme për të na mundësuar ofrimin e shërbimeve që synojnë përmirësimin e shërbimeve tona dhe të përvojës së përdoruesit gjatë shfletimit në platformën tonë. Për më shumë informacion, hyr në panelin e konfigurimit të Cookies, të disponueshëm në çdo moment në platformën tonë.

Për të marrë informacione më të detajuara lidhur me përpunimin e të dhënave të tua personale në bashkëpunimin tonë me palë të treta dhe me ato që janë subjekt i transferimit ndërkombëtar të të dhënave, të sugjerojmë të lexosh Politikën tonë të Privatësisë, të disponueshme në platformën tonë, si dhe politikën e privatësisë/konfigurimet e privatësisë të këtyre palëve të treta, të cilat disponohen në platformat e tyre.